



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.199/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Violeta Husaj Rugova kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë ka paraqitur ankesë kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 28.01.2025, merr këtë:

#### V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, Anr.199/2025 e datës 25.01.2025.
- II. Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 5,000.00 (pesëmijë) euro.
- III. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

#### A r s y e t i m

Me datë 25.01.2025 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën pretendon se më datë 23.01.2025 është mbajtur tubimi i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në lagjen Kodra e Diellit në Prishtinë, në këtë tubim kandidati për deputet dhe kryeparlamentari aktual, Gauk Konjufca, gjatë fjalimit të tij ka theksuar: *“A ka me u qeverisë në Kosovë mas 9 shkurtit shqiptarizmi edhe kombetarizmi shqiptar a ka me u qeverisë bashkë me Beogradin, qikjo është dilema”, ku me këtë është bërë shkelje e rëndë e Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, respektivisht nenit 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11 i cili shprehimisht thotë: “përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë.”* Sipas parashtruesit të ankesës, ky fjalim përbënë krahasim nxitës e provokues, madje mund të

cilësohet se është si urrejtës. Këtu Konjufca aludon në krahasim, se qeverisja me shqiptarizëm apo kombetarizëm nënkupton sipas tij qeverisjen e LVV-së, teksa për qeverisjen bashkë me Beogradin sipas tij nënkupton opozitën (duke përfshirë këtu edhe subjektin tonë politik). Tutje parashtruesi i ankesës ka theksuar se kjo është thirrje direkte për nxitje e provokim, urrejte mes shumicës shqiptare votuese dhe duke u bazuar në gjithë këto prova ka kërkuar nga PZAP, si organ kompetent dhe i autorizuar që të shqiptojë masën adekuate sanksionuese ndaj subjektit politik LVV, që është shkelja e katërt përsëritëse andaj edhe ka kërkuar dënim të lartë për rastin konkret.

Si provë që dëshmon shkeljen e pretenduar ka bashkangjitur një CD.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 27.01.2025 subjekti politik LVV ka theksuar se ankesa është e pa bazuar, kjo për faktin se ankesa nuk përmban ndonjë fakt i cili do ta ndërlidhte veprimin e pretenduar si shkelje të kandidatit, me subjektin ankimes fillimisht dhe e cila gjuhë më pas do të binte ndesh me nenin 34 të LZP-së, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1. Më tutje në përgjigje në ankesë është theksuar se në përputhje me pjesën e parë të nenit 39, par.3, ka vlerësuar se deklarata e tillë e përbërë nga kryeparlamentari Glauk Konjufca nuk cenon asnjë të drejtë sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Sjelljes, sepse me atë deklaratë të pretenduar si shkelje nga parashtruesi, në asnjë moment nuk përmendet subjekti politik LDK apo ndonjë parti tjetër që ekziston e funksion në Kosovë. Parashtruesi i përgjigjes në ankesë ka theksuar se në deklaratë krye parlamentar Konjufca, bazuar në legjislacionin ligjor në fuqi dhe brenda frymës së garës elektorale, shtron një dilemë, kuptimin e në qeverisje të ardhshme të interesave sa më të mirë për vendin dhe kombin dhe pretendimi se qeverisja bashkë me Beogradin, madje pa përmendur në asnjë rast parashtruesin LDK në këtë rast nuk qëndron aspak dhe është jashtë standardeve të tilla të kërkuara edhe me nenin 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11 të LZP-së. Përmes përgjigjes në ankesë ka propozuar që ankesa Anr.199/2025 të refuzohet si e pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, pas shikimit të CD të ofruar si provë materiale, nga e cila rrjedh se në lagjen Kodra e Diellit në Prishtinë, në tubim publik, kandidati për deputet dhe kryeparlamentaritet aktual, Glauk Konjufca, gjatë fjalimit të tij ka theksuar: *“A ka me u qeverisë në Kosovë mas 9 shkurtit shqiptarizmi edhe kombetarizmi shqiptar a ka me u qeverisë bashkë me Beogradin, qikjo është dilema”*, vlerëson se është gjuhë denigruese dhe urrejtëse në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore. Andaj për Panelin përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërisë si në vijim: ... 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së thekson se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) Euro. Përveç kësaj një veprim i tillë sanksionohet edhe me nenin 24 paragrafi 9 nën paragrafi 9.1 Rregullës Nr.01/2024, ku përcaktohet se *“subjekti politik që është përfitues i fondeve për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në pesë dhjetëmijë (50,000.00)euro”*.

Sipas Panelit nga përmbajtja e deklaramit te kandidatit për deputet të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje konsiderohet gjuhë nxitëse dhe urrejtëse *kundrejt të tjerëve* në kuadër të fushatës zgjedhore dhe se kjo konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, ngase veprimi i marrë në kohë të fushatës zgjedhore, konteksti dhe masa që i është drejtuar ka për qëllim të krijojë atmosferë tensioni ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe te përçarjes. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime që mund të sjellin pasiguri apo të përkeqësojnë atmosferën politike dhe ne përgjithësi atmosfere destabiliteti. Përdorimi i gjuhës së tillë mund të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë.

Andaj Paneli gjeti se gjuha e përdorur ndaj kryetarit të subjektit politik LVV është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ka pasur parasysh edhe praktikën e mëhershme për rastet të ngjashme si dhe faktin që subjekti politikë në fjalë ka bërë shkelje të natyrës së njëjtë e për të cilat shkelje paneli ka shqiptuar dënime me gjobë..

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, ku nga kjo përgjigje i njëjti e mohon shkeljen e bërë por në të njëjtën kohë thekson që ankesa është e bazuar në lajmin e publikuar në gazetën Nacionale, andaj pretendimet e parashtruar në përgjigje në ankesë për Panelin janë të pabazuara.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), neni 118 paragraf 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr. 199/2025 më datë 28.01.2025

Kryesues i Panelit  
Violeta Husaj Rugova



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*